

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.R., nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, si dhe ankesa e të dëmtuarit G.Z., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.186/2015, të datës 08.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 21.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pa bazuara, ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.186/2015, të datës 08.11.2016, **vërtetohet.**

II. Hedhet si e palejuar ankesa e të dëmtuarit G.Z..

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr. 186/2015, të datës 08.11.2016, i akuzuari S.R., është liruar nga akuza, në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK, për shkak të veprës penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPK, sepse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet procedurale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, dhe

- i dëmtuari për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari S.R. të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.103/2017, të datës 31.01.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, kurse sa i përket ankesës së të dëmtuarit, e njëjta të hedhet poshtë si e palejuar, sa i përket të gjitha arsyeve.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesës së të dëmtuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par 1 pika 1.12 të KPPK, ngase aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par 7 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë krahasimin adekuat të provave dhe të njëjtat nuk i ka trajtuar sikurse parashohin dispozitat përkatëse ligjore, andaj aktgjykimi në këtë drejtim është i mangët dhe jo i drejtë.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar ankesën e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat tjera të lëndës, përkitazi me shkeljet esenciale, sipas ankesës së prokurorisë, për të cilat përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale për të cilat pretendohet në ankesë, se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat e karakterizojnë çështjen penale, ngase gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme në arsyetim të aktgjykimit për secilën pikë të njëjtit, duke arsyetuar dhe paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, gjithashtu ka paraqitur edhe saktësinë e secilës provë e cila karakterizon çështjen penale, duke ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit nuk qëndrojnë elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, andaj,

aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në masë të duhur provat e procedura, për ta vërtetuar faktet vendimtare të cilat i karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit S.R., por kryesisht besimin ja ka kushtuar deklaratës së të akuzuarit, për kundër asaj që i njëjti në polici ka deklaruar se ka shkaktuar dëm dhe ka shfaqur gatishmëri për ta kompensuar të njëjtin. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerësoj deklaratën e dëshmitarit Z.Z., Sh.Z. si dhe deklaratën e të dëmtuarit G.Z., si dhe foto dokumentacionin nga shkresat e lëndës. Nuk është kontestuese se i akuzuari e ka ditur që ara nëpër të cilën ka kaluar me kombaj, është duke kaluar nëpër arën e të dëmtuarit G.Z., i cili e ka marrur me qira nga M.R., por këtë rrethanë nuk e ka vlerësuar në masë të duhur. I akuzuari është dashur që të merr pëlqimin paraprak nga i dëmtuari, ashtu që deklaratën e të njëjtit sipas të cilës, rezulton se nuk ka kaluar nëpër arë, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që ta vlerësoj ngase gjurmët të cilat kanë mbetur, kanë vërtetuar se ara ditën kritike është dëmtuar me sipërfaqe prej 1 ari, andaj vihet në përfundim se në veprimet e të akuzuarit janë formuar elementet qenësore të veprës penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPPK. Gjukata e shkallës së parë me aktgjykim lirues, nuk ka arritur që të vërtetoj gjendjen faktike në masë të duhur andaj si i tillë aktgjykimi është i pa pranueshëm.

Kolegji i i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së ushtruar dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që me provat e proceduara ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPPK, sepse sipas deklaratës së të akuzuarit, rezulton se i akuzuari në ditën kritike vetëm ka shfrytëzuar rrugën për të kaluar nëpër arë e këto të dëmtuarit, ngase ka patur për të fshirë grurin. Kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe në bazë të deklaratave të tjera sikurse janë i dëmtuari, dëshmitarët, dhe është vërtetuar se i akuzuari vetëm ka bërë të drejtën e shfrytëzimit të rrugës për kalimin e kombajës, ndërsa nuk ka bërë kurrfarë asgjësimi apo dëmtimi të pasurisë, sikurse është akuzuar sepse prona nuk është dëmtuar apo nuk është bërë e pa përdorshme, rrethana të cilat janë të parapara me dispozitën përkatëse ligjore e kjo vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni edhe nga shkresat e lëndës nga i cili rezulton se i akuzuari nuk ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur të akuzuarit në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK e ka liruar nga akuza, pasi që nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Sa i përket ankesës së të dëmtuarit G.Z., përkitazi me bazat ankimore sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljeve të ligjit penal, e njëjta është hudhur sepse nuk është e lejuar, në kuptim të nenit 381 të KPPK. Sa i përket bazës ankimore për shkak të vendimit përkitazi me sanksionin penal, edhe për këtë bazë është hedhur si e palejuar, sepse në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykim lirues.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.80/2017 të datës 21.03.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq